

9.3 ADETIV PËRFORCUES PËR RIFINITURAT DHE LLAÇRAT

LATEX



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
1 kg/bidon	10 cp/kuti	1-3 kg/25 kg produkt	E Bardhë
5 kg/bidon	4 cp/kuti	--	--
10 kg/bidon	60 cp/paletë	--	--



LATEX

është adetiv për përmirësimin e llaçrave me bazë çimentoje.

PËRSHKRIMI

Latex është një polimer sintetik, për përmirësimin e llaçrave me bazë çimento dhe shtresash betoni.

PËRDORIMI I LATEX

- Shtresë lidhëse ndërmjet betonit të vjetër dhe të ri ose llaçit.
- Përmirësimin e llaçit dhe rifiniturave me bazë çimento dhe gëlqereje.
- Rrit ngjitshmërinë e llaçrave dhe papërshkueshmërinë nga uji.
- Përdoret për llaçrat hidroizolues me bazë çimento duke siguruar rezistencë ndaj presionit hidrostatik.
- Përdoret për përmirësimin e rezistencës së llaçrave të themeleve.
- Përmirëson ndjeshëm aftësinë ngjitëse të kollrave, dhe rifiniturave.
- Mbron sipërfaqet e betonit nga dehidratimi.
- Përdorimi i LATEX rrit ndjeshëm ngjitshmërinë, rezistencën mekanike, elasticitetin dhe papërshkueshmërinë nga uji të produkteve të ndërtimit me bazë çimento.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet mbi të cilat do të aplikohet produkti duhet të jenë të pastra nga të gjitha pluhurat, yndyrnat, vajrat, mbetjet e finos, bojrat etj.

APLIKIMI

LATEX përzihet me ujin dhe raporti i përzierjes varet nga karakteristikat që duam t'i japim llaçrave dhe ngjitësave për pllaka. Raporti i përzierjes së LATEX me ujin nuk duhet të jetë më i ulët se 1:5. Nëse ky raport do të jetë shumë i vogël atëherë nuk do të kemi përmirësim dhe përforsim të vetive të llaçrave dhe ngjitësave me bazë çimento. Për përgatitjen e përzierjes së betonit dhe llaçit tradicional, fillimisht hidhet LATEX e më pas çimento dhe rërë për të shmangur krijimin e kokrrizave. Përdorimi i tij rrit ndjeshëm punueshmërinë e produktit dhe kohën e tharjes. Të gjithë llaçrat me bazë çimento të cilat përzihen me LATEX karakterizohen nga ngjitshmëri dhe elasticitet më i lartë se llaçrat të cilët nuk shoqërohen nga LATEX.

